



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 07.02.2025

Nr: 68

Ora: 14:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË VEPRIMTARIVE PUBLIKE TË BASHKISË
LIBRAZHD PËR PERIUdhËN 26 JANAR-01 SHKURT 2025**

Sot, më datë 07.02.2025 unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, mora në shqyrtim çështjen administrative me,

SUBJEKT: Bashkia Librazhd

OBJEKT: Shqyrtimi administrativ i veprimtarive publike të Bashkisë Librazhd për periudhën 26 janar deri më 01 shkurt 2025.

BAZA LIGJORE: Nenet 19 pika 1, shkronja “n”, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, i ndryshuar.

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

KONSTATOJ:

Gjatë periudhës 26 janar-01 shkurt 2025, Bashkia Librazhd ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve (NRI), 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

-Çështje sociale, “Diskutim mbi projekte me karakter social-ekonomik me OJQ”, raportuar në datën 27.1.2025 për t’u zhvilluar në datën 31.1.2025

Nëpërmjet email-it, administrata e KQZ-së i ka kërkuar Bashkisë Librazhd një informacion sqarues në lidhje me shkaqet dhe rrethanat e kryerjes së shkeljes.

Data: 07.02.2025 Nr: 68
Ora: 14:00



“Për shqyrtimin administrativ të veprimtarive publike të Bashkisë Librazhd, për periudhën 26 janar – 01 shkurt 2025”

Pas njoftimit të kryer, personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike të Bashkisë Librazhd ka dërguar pretendimet, duke sqaruar se: *“Bashkia Librazhd si pasojë e një gabimi njerëzor në llogaritjen e afatit 5 ditor ka raportuar jashtë afatit të përcaktuar në nenin 92, pika 2, veprimtarinë me objekt “Çështje sociale”, diskutim mbi projekte me karakter social-ekonomik me OJQ”, raportuar në datë 27.1.2025 për t’u zhvilluar në datën 31.1.2025. KQZ pas këtij raportimi e ka ndaluar zhvillimin e këtij aktiviteti. Menjëherë sapo konstatoam këtë gabim vendosëm që të mos e zhvillojmë këtë aktivitet në këtë datë. Aktiviteti nuk u zhvillua duke respektuar të gjithë detyrimet e përcaktuara në Vendimin nr. 9, datë 24.12.2020. Për këtë qellim, do marrim masat të mos veprojmë më në gabime ose llogaritje gabim të afatit në të ardhmen. Për të njëjtin aktivitet u vendos që aktiviteti të raportohet përsëri në datë 29.1.2025 me datë zhvillimi datë 7.2.2025. Pra aktiviteti nuk është zhvilluar akoma.*

Nga verifikimet e kryera rezulton se ky aktivitet nuk është zhvilluar dhe është riraportuar sërish brenda afatit ligjor.

Për sa më sipër, pasi u njoha me rrethanat dhe faktet e paraqitura, vlerësoj se veprimtaria publike e zhvilluar nga Bashkia Librazhd nuk përbën shkelje, sipas parashikimeve të nenit 92, të Kodit Zgjedhor, dhe të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, i ndryshuar. Pasi veprimtaria ka marrë shënimin “E ndaluar”, në NRI, Bashkia Librazhd nuk e ka zhvilluar këtë aktivitet por e ka riraportuar atë me datën e saktë të zhvillimit, duke respektuar afatet ligjore.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pika 1, shkronja “n”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, i ndryshuar,

V E N D O S:

1. Pushimin e hetimit administrativ ndaj Bashkisë Librazhd.
2. Ky vendim do të njoftohet nëpërmjet postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Illirjan CELIBASHI